



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I EDUKIMIT

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
 Tel: +383 38 229 201 • E-mail: edukimi@uni-pr.edu • edukimi.uni-pr.edu

Tezat e masterit për diskutim publik të miratuara nga Departamenti i Mësimdhënies Lëndore
Me datë 15.11.2022

Vendimet për DISKUTIM PUBLIK						
#	Kandidati	Specializimi	Tema e punimit	Komisioni		
1	Gazmire Hoda Kurteshi	Mës. Tekn.&TIK	Aplikimi i kuizeve dhe ndikimi tyre në mësimdhënien dhe mësimnxënien interaktive të lëndës së Teknologjisë me TIK të arsimit të mesëm të ulët	Kryetar/e	Kyvete Shatri	
				Mentor/e	Florent Bunjaku	
				Anetar/e	Vjollca Ahmedi	
2	Valmira Krasniqi	Mës. Kimi	Sfidat e vlerësimit formativ në mësimdhënien e kimisë në ciklin e mesëm të lartë ndërmjet mësimiit online	Kryetar/e	Arlinda Damoni	
				Mentor/e	Islam Krasniqi	
				Anetar/e	Vjollca Ahmedi	
3	Vanesa Koka	Mës. Matematikë	Sfidat e nxënësve në përdorimin e simboleve matematikore në matematikën e klasës së dhjetë	Kryetar/e	Eda Vula	
				Mentor/e	Xhevat Krasniqi	
				Anetar/e	Jehona Ferizi Miftari	
4	Gazmend Bërbatovci	Mës. Gjeografi	Aplikimi i metodave tradicionale dhe moderne në lëndën e gjeografisë	Kryetar/e	Valbon Bytyqi	
				Mentor/e	Nusret Pllana	
				Anetar/e	Vlora Sylaj	
5	Fidan Kamberi	Mës. Matematikë	Identifikimi i vështirësive të nxënësve në të nxënit e gjeometrisë në shkollën e mesme të ulët 6-9	Kryetar/e	Eda Vula	
				Mentor/e	Xhevat Krasniqi	
				Anetar/e	Teuta Danuza	
6	Minire Balaj Hajdari	Mës. Histori	Rëndësia e vlerësimit formativ në përmirësimin e të nxënit në lëndën e historisë te nxënësit e klasës së gjashtë	Kryetar/e	Veli Kryeziu	
				Mentor/e	Sedat Baraliu	
				Anetar/e	Vjollca Ahmedi	
7	Marigona Berisha	Mës. Gjeografi	Roli i lëndës edukatë qytetare në parandalimin e devijimit të nxënësve në shkollat fillore të mesme të ulëta	Kryetar/e	Ardita Devolli	
				Mentor/e	Nusret Pllana	
				Anetar/e	Veli Kryeziu	
8	Jeton Maliqi	Mës. Gjeografi	Roli i mediave në mësimdhënien e gjeografisë	Kryetar/e	Xhavit Beqiri	
				Mentor/e	Veli Kryeziu	
				Anetar/e	Arsim Ejupi	
9	Arben Bytyçi	Mës. Fizikë	Rëndësia e teorisë në realizimin e eksperimentit në mësimdhënien e fizikës në shkollat e mesme të ulëta	Kryetar/e	Arlinda Damoni	
				Mentor/e	Zeqir Shaqiri	
				Anetar/e	Sylejman Berisha	

Kandidati/ja: 1. Gazmire Hoda Kurteshi

Tema: Aplikimi i kuizeve dhe ndikimi tyre në mësimdhënien dhe mësimnxënien interaktive të lëndës së Teknologjisë me TIK të arsimit të mesëm të ulët

ABSTRAKT

Hulumtimi i ndërmarrë ka synuar të teston aplikimin e kuizeve në performancën e nxënësve kur përdoren, jo vetëm si një mjet vlerësimi, por edhe kur integrohet në një strategji të kombinuar, e cila mbështet programin e përgjithshëm të lëndës.

Ky hulumtim kishte për qëllim të trajton aplikimin dhe ndikimin e kuizeve në mësimdhënien dhe mësimnxënien e Teknologjisë, si një mjet mësimor dhe vlerësimi në dy kapituj të lëndës së Teknologjisë me TIK të klasës së tetë, në SHMU “Abaz Ajeti”- Gjilan.

Një mjet që po bëhet më i zakonshëm, veçanërisht në arsimin nga distanca, janë kuizet. Ato ndihmojnë me përqendrimin, identifikojnë boshllëqet në njohuri, ndërtojnë besimin dhe ndihmojnë nxënësit t të ruajnë informacionin. Për më tepër - ata janë argëtues!

Shqyrtimi i literaturës mbi përdorimin e kuizeve nga mësimdhënësit zhvillohet sipas këndvështrimeve dhe teorive të ndryshme nga artikuj të ndryshëm të cilët japin versionet e tyre për rëndësinë e përdorimit të kuizeve gjatë procesit mësimor.

Në këtë hulumtim është përdorur metoda kërkimore sasiore, me metodën kuazi eksperimental. Mostrën e përbëjnë dy grupe të klasave të VIII-ta të kësaj shkolle, pjesëmarrës janë rreth 40 nxënës, ku dy grupet e klasave janë të njëjtit nivel, si dhe në hulumtim do të marrin pjesë edhe 4 mësimdhënës të lëndës së Teknologjisë me TIK. Përmbajtja në këtë hulumtim përfshinë dy njësi mësimore nga kapitulli Pajisjet teknike dhe teknologjike dhe dy njësi mësimore nga kapitulli Teknologjia e Transportit.

Instrumentet që janë përdorur për këtë hulumtim janë: vëzhgimi në klasë, paratesti - pastesti dhe pyetëtori. Në këtë hulumtim është përdorur metoda kërkimore sasiore dhe metoda e hulumtimit në veprim, me metodën kuazi eksperimental. Në këtë hulumtim është përdorur analiza deskriptive dhe krahasuese e të dhënave. Analizën e të dhënave do ta bëjmë me programin SPSS.

Nga rezultatet e marra nga t-Testi ka pasur një ndryshim të rëndësishëm të mesatarja aritmetike në mes grupit të kontrollit në të cilin nuk janë aplikuar kuizet dhe grupit eksperimental ku mbajtja e orëve mësimore është zhvilluar duke aplikuar kuizet.

Fjalët kyçe: kuize, mësimdhënie, mësimnxënie, teknologji etj.

Kandidati/ja: 2. Valmira Krasniqi

Tema: Sfidat e vlerësimit formativ në mësimdhënien e kimisë në ciklin e mesëm të lartë ndërmjet mësimin online

ABSTRAKTI

Zhvillimi i shpejtë i teknologjisë informative, veçanërisht e internetit hap mundësinë e të mësuarit dhe vlerësuarit online e cila është ndryshme nga mësimdhënia në klasa. Qasja e-mësimin ndërkombëtarisht është konsideruar e nevojshme dhe mundëson që nxënësit e shekullit njëzetënjë të përshtaten me ndryshimet globale, kjo ka ndodhë edhe në Kosovë si pasojë e shfaqjes së pandemisë COVID-19.

Qëllimi përfundimtar i hulumtimit është njoftimi me sfidat vlerësuese formative gjatë mësimin online nga mësimdhënësit, ndikimi i instrumenteve, strategjive dhe metodave vlerësuese formative, dhënien e informatave kthyesë për performancën e nxënësve në mësimin online, si dhe përparësitë dhe mangësitë e të nxënësve me përdorimin e këtyre instrumenteve vlerësuese gjatë mësimin online. Instrumentet për mbledhjen e të dhënave janë pyetësor për mësimdhënësit të realizuar në mënyrë fizike, ndërsa të dhënat janë informacione që kanë të bëjnë me identifikimin e sfidave të cilat përballen mësimdhënësit gjatë vlerësimit formativ në mësimin online dhe ndikimin e tyre në të nxënësve e nxënësve.

Mostra të studimit janë mësimdhënësit e shkollave të ciklit të mesëm të lartë në Komunën e Prishtinës, dmth mostra është bërë në popullacion me të gjithë këta mësimdhënësit përveç ato shkolla ku nuk kemi mësimdhënësit të lëndës së kimisë.

Hulumtimi ka zgjatur me muaj të tërë për shkak të gjendjes së rënduar me pandeminë Covid 19 dhe është kryer në shkollat: “Dr.Ali Sokoli”, “Xhevdet Doda”, ”Sami Frashër”, ”Ahmet Gashi”, “Abdyl Frashëri”, ”28 Nëntori”, ”Eqrem Çabej”. Pjesëmarrës në hulumtim janë 19 mësimdhënësit të kimisë së këtyre shkollave. Realizimi i pyetësorit me pyetjet opcionale ka zgjatur shkurt, maximum 10 minuta, në mënyrë që të mos pengohet procesi mësimor dhe aktiviteti personal dhe profesional i mësimdhënësit. Përgjigjet në pyetësor të secilit mësimdhënësit janë mbledhur si të dhëna për realizimin e studimit, dhe nga përgjigjet e marra mendoj se mësimdhënësit ishin të kënaqur për realizimin e një hulumtimi të tillë sepse vërtet ndjenin nevojën të ndanin përvojën e tyre për të vlerësuarit e mësimdhënies së kimisë online.

Nisur nga rezultatet, mund të themi se përdorimi i vlerësimit formativ në mësimdhënien online të kimisë ka pas shumë sfida të cilat kanë pasur efekte në përdorimin e këtij vlerësimit dhe të nxënësve e nxënësve.

Fjalët kyçe: Hulumtim, pyetësor, mësimdhënia online, vlerësim formativ

Kandidati/ja: 3. Vanesa Koka

Tema: Sfidat e nxënësve në përdorimin e simboleve matematikore në matematikën e klasës së dhjetë

ABSTRAKTI

Sfidat dhe vështirësitë që lidhen me mësimdhënien dhe të nxënët e matematikës janë shumëdimensionale. Arcavi (1994) prezanton nocionin e kuptimit të simbolit si një “qëllim i dëshiruar për edukimin matematikor”.

Ky hulumtim përqipet të tregoj se një nxënës me kuptim simbolik ka më pak gjasa të bëjë gabime të zakonshme dhe të shfaqë keqkuptime. Kështu, duke eksploruar përgjigjet e nxënësve shpresohet të përcaktohet shkalla në të cilën këta kanë kuptim simbolik.

Qëllimi i këtij studimi është të nxirren konkludime mbi vështirësitë e studentëve për përdorimin e simboleve matematikore si dhe të identifikojë nivelin e të kuptuarit nga nxënësit të simboleve matematikore në matematikën e klasës së 10-të. Pyetjet e hulumtimit janë: a. Cili është niveli i të kuptuarit i nxënësve të simboleve matematikore në matematikën e klasës së 10- të? b. Cilat sfida hasin nxënësit e shkollave të mesme kur përdorin simbolet matematikore?

Dizajni përshkruet i hulumtimit është përdorur për të dhënat sasiore të mbledhura duke përdorur anketën e pyetësorit dhe testin. Modeli i përdorur është modeli jo-eksperimental.

Hulumtimi zhvillohet në dy shkolla të mesme të larta në Komunën e Kaçanikut, respektivisht në Gjimnazin “Skenderbeu” dhe sh.m.p “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka”. Popullata e synuar përbëhet nga nxënës të klasës së 10-të. Kampionimi i qëllimshëm është përdorur për të zgjedhur pjesëmarrësit, shkollat dhe studentët. Mostra për studim ka nxënës të klasës së 10-të, ku nga ta do të përzgjedhen dy klasë të Gjimnazit “Skenderbeu” dhe tri klasë të sh.m.p “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka”. Arsyeja e përfshirjes së nxënësve të këtij niveli të klasave ishte se ata kishin ekspozim adekuat ndaj një sërë simbolesh matematikore të shkruara në tekstet e tyre shkollore. Në këtë studim, morën pjesë 89 nxënës të klasës së 10-të.

Fjalët kyçe: *Simbolet matematikore, Sfidat, Kuptimi.*

Kandidati/ja: 4. Gazmend Bërbatovci

Tema: **Aplikimi i metodave tradicionale dhe moderne në lëndën e gjeografisë**

ABSTRAKTI

Metoda mësimore është mënyrë, mjet dhe formë e veprimit në punën mësimore përmes së cilës bëhet përvetësimi i diturive, shprehive, shkathëtësive dhe përpunohet materiali edukativo – mësimor. Metodatat dhe Strategjitë e të mësuarit, secila me specifikat e saj vlejn për të realizuar qëllime të caktuara të orës mësimore. Qëllimi i këtij hulumtimi ka të bëjë me zbatimin e metodave mësimore Tradicionale dhe Moderne (Bashkëkohore) në lëndën e gjeografisë në Shkollat e Komunës së Lipjanit. Për ta realizuar këtë hulumtim do të mblidhen dhe analizohen të dhënat nga mësimdhënësit e gjeografisë se si i aplikojnë këto metoda dhe cilat janë rezultatet e arritura për secilën metodë mësimore në kuadër të shkollave të Komunës së Lipjanit. Poashtu do të analizohen të dhënat nga një numër i caktuar i nxënësve në shkollat e Komunës së Lipjanit, në lidhje me të mirat dhe të metat që ka zbatimin e këtyre metodave për nxënësit.

Aplikimi i metodave në fjalë sidomos metodoat bashkëkohore çdo ditë e më tepër po rritet si rrjedhojë e përmirësimit të infrastrukturës shkollore, pajisjen e shkollave me teknologji moderne dhe rregullimin e kabinetëve dhe nëpër vendbanimet rurale, pasi që shkollat në vendbanime rurale kanë infrastruktur më të dobët në raport me shkollat që janë dhe funksionojnë brenda qytetit të Lipjanit, ndërsa hulumtimi është realizuar nëpërmjet këtyre metodave: analizës, konkretizimit, krahasimit, vështrimit dhe metodës statistikore.

Konkretizimi i mësimin nëpërmjet përdorimit të mjeteve ndihmëse didaktike në lëndën e Gjeografisë është një nga parimet e rëndësishme për të realizuar një përvetësim në mënyrë të ndërgjegjshme e të qëndrueshme të njohurive. Në thelb të këtij parimi didaktik qëndron kërkesa që, për formimin e përfytyrimeve dhe koncepteve, mësimi të zhvillohet mbi bazën e perceptimit të drejtpërdrejtë të sendeve dhe dukurive të realitetit. Zbatimi i këtij parimi bazohet në arsye logjike, psikologjike e pedagogjike dhe kushtëzohet nga veçoritë e zhvillimit psikik të moshës së nxënësve, nga veçoritë e zhvillimit të proceseve njohëse si; perceptimi, kujtesa, të menduarit etj., të cilat kanë si veçori të rëndësishme karakterin figurativ. Përdorimi i mjeteve ndihmëse didaktike është i nevojshëm në të gjithë nivelet e sistemit arsimor sepse ndihmon për të kuptuar më mirë marrëdhëniet që ekzistojnë në realitet midis dukurive e fenomeneve të ndryshme, për të formuar ide e koncepte të qarta e të plota e për të përvehtësuar njohuritë në mënyrë të ndërgjegjshme e të qëndrueshme.

Fjalët kyçe: aplikim, zbatim, metodë, tradicional, bashkëkohorë, analizë, mësimdhënie etj.

Kandidati/ja: 5. Fidan Kamberi

Tema: **Identifikimi i vështirësive të nxënësve në të nxënit e gjeometrisë në shkollën e mesme të ulët 6-9**

ABSTRAKTI

Qëllimi i këtij punimi është identifikimi i vështirësive të nxënësve në të nxënit e gjeometrisë në shkollën e mesme të ulët (6-9). Më saktësisht, në këtë punim kemi identifikuar se cilat janë vështirësitë dhe problemet apo ngeçjet që nxënësit i hasin në të nxënit e gjeometrisë në shkollën e mesme të ulët (6-9).

Hulumtimi është kuantitativ. Ai është realizuar në komunën e Mitrovicës dhe mostër e hulumtimit janë nxënësit dhe mësime të matematikës në klasat (6-9).

Metoda e mbledhjes së të dhënave është metodë e strukturuar nga hulumtuesi, ku hulumtuesi ka vendosur për pyetjet që bëhen, ashtu edhe për llojin e përgjigjes që pritet të jepet.

Nga analiza e të dhënave është bërë identifikimi i vështirësive apo problemeve që nxënësit i hasin në të nxënit e gjeometrisë në shkollën e mesme të ulët (6-9).

Hulumtimi tregon se si është arritur identifikimi i problemeve të nxënësve në të nxënit e gjeometrisë dhe cilat vështirësi janë identifikuar. Gjithashtu në fund tregon edhe për vështirësitë që hasin mësime të matematikës gjatë mësimit të gjeometrisë.

Fjalët kyçe: Matematika, nxënësi, të nxënit, gjeometria, vështirësitë etj.

Kandidati/ja: 6. Minire Balaj-Hajdari

Tema: Rëndësia e vlerësimit formativ në përmirësimin e të nxënësve në lëndën e historisë të nxënësve të klasës së gjashtë

ABSTRAKTI

Vlerësimi formativ është mjaftë i rëndësishëm, sidomos për mësuesin, të cilët përmes përdorimit të kësaj forme të vlerësimit, mundë të identifikojnë materialet të cilat duhet të qartësohen ose ri-mësohen për notimin e nxënësve. Duke qenë se vlerësimi formativ është një proces sistematik për mbledhjen e vazhdueshme të dëshmive rreth të nxënësve, mundëson që të dhënat të cilat dalin nga ky proces, mundë të përdoren për të identifikuar nivelin aktual të të nxënësve të një nxënësi dhe për të përshtatur mësimet dhe për të ndihmuar nxënësin të arrijë qëllimin e dëshiruar të të mësuarit.

Duke e parë si shumë të rëndësishëm këtë vlerësim, hulumtimi im ka për qëllim identifikimin e strategjive kryesore, si dhe nivelin e përdorimit të vlerësimit formativ nga mësuesin e klasës së VI-shtë për lëndën e historisë. Për të pasur rezultate sa më të mira, për të realizuar këtë hulumtim unë do të përdori metodologjin e kombinuar, duke u përbërë nga aspekte sasiore (kuantitative) dhe cilësore (kualitative). Për të realizuar këtë hulumtim unë do të anketoj nxënës dhe mësues.

Pyetjet e anketës, e cila është realizuar me nxënës, dhe ato të intervistës e cila është realizuar me mësues janë orientuar në gjetjen e strategjisë së vlerësimit formativ dhe se sa përdoren në lëndën e historisë. Ky hulumtim poashtu ka pasqyruar edhe ndikimin e disa variablave demografike (gjinia dhe vendbanimi) në preferencat dhe zbatimin ndaj disa prej formave specifike të vlerësimit formativ, si dhe marrëdhënien ekzistuese mes qëndrimeve ndaj vlerësimit formativ dhe nivelit të zbatimit të tij praktik në klasë për lëndën e historisë.

Fjalët Kyçe: vlerësimi formativ, strategji, mësues, nxënës, histori, klasët egjashta

Kandidati/ja: 7. Marigona Berisha

Tema: Roli i lëndës edukatë qytetare në parandalimin e devijimit të nxënësve në shkollat fillore të mesme të ulëta

ABSTRAKTI

Sjelljet e nxënësve në klasë, shkollë, familje dhe shoqëri varen nga njohuritë që ata marrin në shkollë. Lënda kryesore që përgatit nxënësit për edukatë dhe sjellje është edukata qytetare.

Edukimi qytetar i nxënësit kërkon punë dhe angazhim të vazhdueshëm nga të gjithë akterët që e rrethojnë atë. Në formësimin e njohurive dhe vlerave kulturore rol të rëndësishëm luan lënda e edukatës qytetare. Qëllimi i këtij hulumtimi është të zbulojë rolin e lëndës së edukatës qytetare në parandalimin e devijimit të nxënësve në shkollat e mesme të ulëta.

Qasja e këtij hulumtimi është kualitative dhe ka për qëllim identifikimin e rolit të lëndës së edukatës qytetare në parandalimin e devijimit të nxënësve në shkollat fillore të mesme të ulëta.

Dizajni i hulumtimit është studim rasti me mësimdhënës të edukatës qytetare. Pjesëmarrës në këtë hulumtim janë mësimdhënësit e lëndës së edukatës qytetare të katër shkollave të komunës së Prizrenit.

Instrumenti i përdorur për realizimin e këtij studimi është intervista me pyetje të hapura që është realizuar me mësimdhënësit e lëndës së edukatës qytetare.

Fjalët kyçe: devijim, edukatë qytetare, nxënës, parandalim, shkolla fillore.

Kandidati/ja: 8. Jeton Maliqi

Tema: Roli i mediave në mësimdhënien e gjeografisë

ABSTRAKTI

Ky punim do të shqyrtoj temën për rolin e medias në mësimdhënie në fushën e edukimit në përgjithësi, dhe në veçanti do të trajtoj rolin e medias në lëndën e gjeografisë.

Çdo ditë e më shumë mediat po e rrisin rëndësinë dhe ndikimi i tyre në jetën tonë të përditshme është i pashmangshëm, dhe si rrjedhojë ndikimi shtrihet edhe në fushën e edukimit, më konkretisht në shkolla. Ndaj themi se sa më shumë që të përdoret media në mësimdhënien e gjeografisë aq më të mira do të jenë rezultatet. Për ta thjeshtësuar këtë, do të filloj me një fjali të njohur për të gjithë “Foto sa një mijë fjalë”, me këtë dua të them që një mësues i gjeografisë me anë të një fotografie mund të arrijë atë që nuk do të mund ta thoshte me qindra apo mijëra fjalë. Pyetjet e hulumtimit janë ndërlidhur me rolin dhe rëndësinë e përdorimit të mediave në lëndën e gjeografisë. Punimi është ndërtuar mbi hipotezat se përdorimi i mediave në lëndën e gjeografisë ndikon në performancën e nxënësve. Punimi bazohet në qasje metodologjike të kombinuara, e cila i merr në konsideratë metodat cilësore dhe sasimore. Për nxjerrjen e rezultateve sasimore është përdorur programi statistikor SPSS, ndërsa për ato cilësore do ta realizojmë përmes metodës përshkruese. Në këtë lloj hulumtimi, studiuesi përdor një anketë ose pyetësorë për një grup të caktuar njerëzish të quajtur kampion – për të përshkruar opinionet, qëndrimet, sjelljet ose karakteristikat për një grup të madh njerëzish të quajtur popullsi. Popullata e këtij studimi përbëhet nga 8 mësues të gjeografisë në disa shkolla fillore të Komunës së Kamenicës e po ashtu edhe mësues nga disa qytete të tjera të Kosovës, si dhe 150 nxënës kryesisht të qytetit të Kamenicës dhe disa fshatrave përreth.

Ky punim rezulton që përdorimi i mediave në mësimdhënie në lëndën e gjeografisë ndikon në performancën e tyre në studime. Konkluzionet dhe rekomandimet e nxjerra ndihmojnë jo vetëm tek mësuesit e lëndës së gjeografisë dhe nxënësve, por edhe Ministrisë së Arsimit, Drejtorive të Arsimit dhe institucioneve përkatëse.

Fjalët kyçe: Media, lënda e gjeografisë, mësimdhënia, performanca e nxënësve

Kandidati/ja: 9. Arben Bytyçi

Tema: Rëndësia e teorisë në realizimin e eksperimentit në mësimdhënien e fizikës në shkollat e mesme të ulëta

ABSTRAKTI

Lidhja e teorisë me eksperimentin është shumë e rëndësishme në të nxënit e Fizikës në shkollat e mesme të ulëta. Nxënësit qysh nga klasa e gjashtë janë të interesuar për eksperimente në lëndën e Fizikës, por për të kuptuar ato më lehtë atyre u duhet të kenë njohuri të mjaftueshme për eksperimentin si dhe të kuptojnë teorinë që eksperimenti të përfundoj me rezultat të mirë. Duke u nisur nga arsyeja dhe mendimi se vështirësitë e nxënësve në nxënien e lëndës së Fizikës është problem mjaft serioz dhe i ndërlikuar e sidomos kuptimi i eksperimenteve në Fizikë, dhe se kjo është veprimtari me interes të përgjithshëm, si për nxënësin ashtu edhe për mësimdhënësin, konsideroj se vlen të hulumtohet edhe teorikisht edhe në aspektin praktik.

Mësimdhënia bashkëkohore në lëndët shkencore, e posaçërisht në lëndën e fizikës, kërkon zbatimin e metodave specifike të mësimdhënies dhe mësimnxënies me qëllim të arritjes së rezultateve sa më të mira në të nxënit e saj. Një prej metodave më efektive padyshim është edhe metoda e eksperimenteve demonstruese e cila në Kosovë nuk ka një zbatueshmëri të gjerë. Kështu një hulumtim për rëndësin e teorisë në eksperimente në të nxënit e fizikës në shkollat e mesme të ulëta padyshim se do të jetë me interes të veçantë.

Për hulumtim janë marrë shkolla të mesme të ulëta në komunën e Malishevës, SHMU "Afrim Krasniqi" në Bardh dhe SHMU "Salih Bytyçi" në Shkozë si dhe disa mësimdhënësit të lëndës së fizikës nga komuna e Malishevës.

Prandaj, në lidhje me këtë temë, pyetja hulumtuese është: sa ndikon teoria në zhvillimin e eksperimenteve demonstruese në përvetësimin e koncepteve dhe përmbajtjeve mësimore të fizikës tek nxënësit e shkollave të mesme të ulëta?

Në bazë të pyetjes hulumtuese, mund të nxjerrim një hipotezë kryesore: teoria është shumë e rëndësishme për zhvillimin e eksperimenteve në lëndën e Fizikës.

Si metodë hulumtuese do të përdoret metoda statistikore. Mbledhja e të dhënave bëhet përmes pyetësorëve dhe intervistave të organizuar me nxënës dhe mësimdhënësit të lëndës së fizikës.

Përmes këtij hulumtimi presim të gjejmë ndonjë zgjidhje për lehtësimin e zhvillimit të eksperimenteve në laboratorët e fizikës nga nxënësit e shkollave të mesme të ulëta.

Fjalët kyçe: eksperimenti, fizika, laborator, mësimdhënia, teoria.